


BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-93-32

245

Thanas
Qerama



ROBOTI
I PABINDUR

TREGIME FANTASTIKO - SHKENCORE

8117-P5-32

245

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

Thanas Qerama

2082

ROBOTI I PABINDUR

TREGIME

FANTASTIKO - SHKENCORE

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

ROBOTI I PABINDUR

Ngjarja, që do t'ju tregoj, ka ndodhur rreth 30 vjet më parë. Në mos gabohem, ka qenë fundi i janarit ose fillimi i shkurtit të vitit dy mijë e... Kjo ngjarje, që kaloi fare pa u vënë re nga shumë njerëz, nuk qe pa rëndësi për klasën tonë e aq më tepër për njërin nga shokët tanë, Blerimin.

*
* *

Bashkë me Sokolin, një shok klase, ishin mbyllur në dhomën time të studimit dhe po zgjidhnim disa detyra të vështira. Do të kishim mbaruar me

kohë, por se ku kishim bërë me siguri ndonjë gabim e nuk po na dilte përfundimi në rregull. U përpoqëm një copë herë. Në shtëpi, atë kohë ndodhej edhe babai, por as na shkonte ndër mend ta pyesnim. Me siguri, ai do të na shihte pa folur dhe pastaj do të na thoshte:

— Detyrat që më ngarkojnë, unë i zgjidh vetë. Me sa di unë, atë detyrë duhet ta zgjidhni ju!

Ishte një gjë krejt e veçantë, bile tepër e çuditshme, po të merrej vesh se detyrat e ndonjë nxënësi i kishte zgjidhur prindi i tij. Turp më të madh nuk kishte. Ndjaj vazhduam të përpiqeshim vetë.

Isha zhytur i tëri në llogaritje, kur dëgjova sinjalin e videofonit. U ngrita si me përtim dhe shtypa butonin. Pamja që pashë tek ekrani i videofonit më shtangu. Mira me lot në sy, duke qarë me dënesë.

— Mira, — thashë unë me nxitim.

— Admir, — mezi foli ajo, — një aksident, ka ndodhur një aksident me Blerimin!

— Çfarë? — gati bërtiti Sokoli, që ishte ngritur me vrell.

— Blerimin, — tha ajo, — para 10 minutash... e sulmoi...

— Kush, moj? — pyetëm në një zë unë e Sokoli.

—... e sulmoi një... robot...

— Një robot? Si kështu? Ku është tani Blerimi?

— Është plagosur dhe gjendet pa ndjenja në spitalin e urgjencës kirurgjikale të Plepat e Durrësit.

— Pse në Durrës? — u hodh Sokoli. — Ta kishin shtruar në Tiranë.

— Ai spital është i specializuar për thyerjet e kockave të fëmijëve. Dysohet se ka thyer këmbën!

Sokoli pa orën. Ajo tregonte 16 e 20 minuta.

— Të nisemi sa më shpejt, — thashë unë. — Mira, na prit te stacioni qendror i trenit të nëndheshëm.

Mira u zhduk nga ekrani dhe unë formova në videofon numrin e stacionit.

— Ju lutem, kur niset treni më i parë për të Plepat e Durrësit?


— Pas 4 minutash, — u përgjigj dezurni dhe mbylli videofonin.

— Shpejt, — tha Sokoli.

Pas një minute ndodheshim në rrugë. Sokoli vrapoi pranë një kutie telefonike dhe njoftoi:

— Në rrugën «Bajram Curri», pranë kabinës urbane nr. 127, presin dy udhëtarë për në stacionin qendror të trenit të nëndheshëm.

Urbani nuk vonoi të vinte. Ishte një anije, edhe si autobus edhe si helikopter. Fluturonte me shpejtësi mbi pallatet e qytetit. Ai qëndroi sipër kokave tona dhe lëshoi disa shkallë metalike. U ngjitëm shpejt dhe zumë vend. Pas pak zbritëm



në fushën e Yzberishit, te dera e stacionit. Mira kishte arritur para nesh. Ora tani shënonte 16 e 23 minuta. U sulëm me vrap dhe sapo kishim vënë këmbën në vagon, kur pas nesh u mbyllën me shpejtësi dyert. Ndjemë një tronditje të vogël; siç duket, treni u nis dhe filloi të rrëshqiste me shpejtësi mbi jastëkët e tij të ajrit. Nuk u ulëm fare. Kishim vetëm disa kilometra rrugë për të bërë, rreth 30 kilometra, dhe, të uleshe në ndénjëse për një copë rrugë, nuk ia vlente. Desha ta pyesja më tej Mirën për plagosjen e Blerimit, por nuk e di ç'm'u kujtua dhe heshta.

«Admir, — i thashë vetes, — përgatitu të japësh llogari për fatkeqësinë që i ndodhi shokut. Je pikërisht ti që e çove atë drejt rrezikut».

U skuqa në fytyrë dhe nuk fola. Edhe Sokoli po më shihte me një vështrim të çuditshëm. Vetëm unë mund ta kuptoja se ç'donin të thoshin sytë e tij.

*
* *
*

Çdo gjë filloi para një muaji. Një pasdite, një sinjal i fortë më ngriti nga vendi dhe shtypa butonin e rrjetit televiziv të shtëpisë. Në ekran u duk Blerimi.

«Po ky, — mendova, — çfarë kërkon në këtë orë?»

Ishte koha kur të gjithë ne, nxënësit e klasës së tetë, sipas regjimit ditor të vendosur bashkërisht, studionim për ditën e nesërme. Dola e hapa derën. Blerimi mbante në dorë një top futbolloi dhe më tha:

— Eja, shkojmë e lozim. Është top i ri fare.

E pashë me çudi.

— Në këtë orë? — thashë. — Tani duhet të studiojmë, nuk është koha për lojë.

— Pse, — u çudit Blerimi, — s'ke mbaruar? Problemet e matematikës nuk ishin fort të vështira. Pastaj ti je i përgatitur e i zgjidh shpejt.

— Nuk i kam zgjidhur, — i thashë, — por, edhe sikur t'i kisha zgjidhur, në orarin tim të veprimeve tani kam studim e jo lojë.

— E mo, ç'bëhesh dhe ti? Se mos do të vijë mësuesja të na kontrollojë zbatimin e orarit, — tha me të tallur Blerimi.

— Jo, Blerim, unë orarin nuk e zbatoj nga frika.

— Si të kesh qejf, — u mërzit pak Blerimi, — unë mendova për çlodhjen tënde.

Dhe u largua duke përplasur topin në tokë di-
sa herë.

U futa përsëri brenda dhe vazhdova studimin. Nuk më hiqej nga mendja biseda me të. Nuk arrija ta kuptoja. Blerimi ishte nxënësi më i dobët në

matematikë e megjithatë i kushtonte pak kujdes kësaj lënde. Me pak mund problemet zgjidheshin; le që unë isha gjithnjë i gatshëm ta ndihmoja.

Të nesërmen u bëra kureshtar të dija si do të përgjigjej Blerimi, në qoftë se do të ngrihej në mësim.

Sikur të ma kishte blerë mendjen, mësuesja thirri emrin e tij. Ktheva me shpejtësi kokën. Nuk e di pse më erdhi keq për të. A do të skuqej ndopak kur t'i thoshte mësueses se nuk dinte t'i zgjidhte problemet? Sokoli, shoku im i bankës, e vuri re shqetësimin tim dhe më pyeti:

— Çfarë ke, pse shikon ashtu?

— Blerimi tërë pasditen dje ka lozur futboll, — pëshpërita unë, — me siguri do të jetë i papërgatitur.

— Po ai duket fare i qetë! — më tha Sokoli i habitur.

Vërtet, Blerimi, fytyrëqeshur, iu afrua plot siguri dërrasës së zezë dhe, me shkumësin në dorë, po priste të merrte detyrën.

Problemi që i dha mësuesja ishte nga më të vështirët. Edhe Sokolit, që mbahej si më i miri i klasës në matematikë, do t'i duhej të djersinte mirë para se ta zgjidhte.

Po çudi. Kjo gjë nuk e stepi fare Blerimin. Ai filloi ta shtronte shumë mirë problemin dhe ta zgjidhte po me atë siguri. Përfundimi ishte i saktë.

— Shumë mirë, — tha mësuesja. Blerimi u ul në bankë.

— S'duhet menduar kështu si ti për shokët, — më tërhoqi vërejtjen Sokoli. — Blerimi ishte përgatitur shumë mirë.

— Po... kur... — u hutova unë, — tërë pasditen ai ka lozur!

Sokoli ngriti supet dhe ndoqi me vëmendje shpjegimin e mësueses.

Atë ditë dhe ditët e tjera, mendja më rrihte vetëm te Blerimi. Më bëhej qejfi që edhe ai kishte filluar të përgatitej ashtu si shokët, por përsëri krimbi i dyshimit më brente nga brenda. Dhe jo kot. Si më parë, çdo pasdite e shihja Blerimin të humbte mjaft kohë vetëm për lojëra. Kur studionte ai? Natën? Ishte e pamundur! Shëndeti i një fëmije nuk mund ta duronte një gjë të tillë. Ishte tashmë e provuar shkencërisht se përgatitja nuk mund të bëhej kurrsesi pas lojërave të lodhshme të futbollit, e aq më pak në orët e vona të natës.

Kishte kaluar gati një muaj nga dita e parë kur më lindi ky dyshim, dhe ndërkaq mësuesja thoshte fjalët më të mira për Blerimin. Ishte bërë, mund të thoshe, më i miri i klasës sonë në matematikë... Sjelljen e tij pasditeve e kishte vënë re edhe Sokoli. Edhe atij i kishte lindur dyshimi se kur dhe si mësonte Blerimi. Por asgjë nuk mund të merrmim me mend.